**KËRKESË**
**Nr. 117/5, datë 18.8.2021**

**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësim shpall kërkesën "Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive, pronë private, që preken nga projekti 'Ndërtim sistemim i rrugës Gjykatë –Akademia e Marinës – 7 pallatet, faza I'".

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Vlorë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për interes publik për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Vlorë, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 545,150 (pesëqind e dyzet e pesë mijë e njëqind e pesëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
**Erlis Hereni**

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
DREJTOR I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
**Klodiana Guci**

LISTA EMËRORE E PRONARIT PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.595, DATË 31.08.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIM SISTEMIM I RRUGËS GJYKATË-AKADEMIA E MARINËS-7 PALLATET, FAZA I".

| Nr. | Emër Atesi Mbiemër | Z.K. | Nr. i pasurisë | Lloj i pasurise | Sip. Totale /m² | Sip.e shpronësuar/ m² | Çmimi në lekë /m² | Vlera totale për shpronësim | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Bp Sudiku | 8602 | 36/277 | truall | | 50 | 10,903 | 545,150 | Konfirmuar nga ASHK |
| | Vlera totale | | | | | 50 | | 545,150 | |

**Shënime:**

1. *Për tokën "Truall", çmimi i llogaritur është marrë nga Vendimi nr. 89, datë 03.02.2016 i Këshillit të Ministarve "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikan e Shqipërisë";*